


# FRYMË DEMOKRATIKE



NË “DEMOS-TI.”

## NE VENDOSIM SEPSE NE E KEMI FUQINË

LEON (11), SUEL (11), ORSA (11), ERLIS (11), EDA (11), ORGES (12), BENJAMIN (11)



### Çdo ëndërr, realizohet me punë

Sipas nesh, demokracia së pari fillon me një fjalë të madhe, e cila quhet barazi. Barazia është element primar për një qeverisje të mirë. Ne kur punojmë në një grup, ose në një bashkësi, të gjithë i japim idetë tona dhe shprehemi lirshëm, pa dallime nga njëri-tjetri. Por, a e dini se çka është demokracia? Demokracia në gjuhën shqipe do të thotë udhëheqje e popullit.

Në vijim do ta ndajmë me ju një eksperiencë tonën e cila lidhet me një element tjetër të demokracisë. E kemi fjalën për solidaritetin.

Dy mësimdhënës, bashkë me klasën tonë, kanë bërë punë vullnetare. Ne të gjithë kemi përgatitur ëmbël-sira të ndryshme dhe ua kemi dërguar familjeve me kushte jo të mira ekonomike. Disa të tjera i kemi shitur, në mënyrë që ta rregullojmë shkollën dhe klasët tona.

Harruam të cekim se ishte edhe një aktivitet, ku ishin të pranishëm edhe fëmijët me nevoja të veçanta. Ne i përkrahëm ata jashtë mase dhe e treguam veten se jemi njerëz solidar, duke iu dhuruar atyre lodra të ndryshme dhe dashuri.

Një ditë, në oborrin e shkollës ishte një vajzë duke qarë, sepse kishte një bregë të madhe. Shoqet e saja nuk e lejonin të luanin dhe as të fliste lirshëm. Kështu, kaluan ditë dhe klasa jonë e kuptoi se çfarë kishte ndodhur. Ne biseduam me shoqet e saj dhe e zgjodhëm problemin në mënyrë paqësore. Që nga ajo ditë, ajo vajzë trajtohet njëjtë me gjithë të tjerët.

Ne të gjithë jemi njerëz nga mishi dhe gjaku, prandaj edhe duhet t'i trajtojmë të gjithë në mënyrë të barabartë. Në demokraci të gjithë jemi të tillë. Ëndrra jonë është që në të ardhmen të kemi një shtet edhe më demokratik se që është tani.




Oytetarët mund të protestojnë në mënyrë paqësore



Autorët e artikullit të demokracisë

# NDIKIMI I KUVENDIT NË JETËN TONË

GJINI (11), KLEIDI (12), FATLIND (12), OLTİ (11), KLEA (11), JONA (11), ARSA (11), KALTRINA (11)



## A e keni menduar ndonjëherë se çfarë funksioni kryen Kuvendi për popullin? Pikërisht këtë do ta mësoni nga artikulli ynë

Kuvendi ndikon në jetën tonë të përditshme. Ai zgjidh problemet që kemi ne me anë të miratimit të ligjeve. Si do të ishte jeta jonë pa ligje? Pa ligje nuk do të vihej në pah barazia që tashmë ekziston mes qytetarëve. Po ashtu, pa ligje, jeta e çdo qytetari nuk do të ishte e sigurt. Prandaj, në Kuvendin e Republikës së Kosovës,

së barazisë efektive dhe realizimi i parimit të trajtimit të barabartë të qytetarëve të Kosovës para ligjit.“ Me këtë nënkuptojmë se parimet dhe vlerat e demokracisë janë të mbrojtura edhe me ligj. Me anë të miratimit të ligjeve të tilla, tregohet se sa demokratik është shteti i Kosovës. Po ashtu, rëndësinë e Kuvendit mund ta shohim me vetë praninë tonë në projektin „Demos-ti“. Këtu ne kemi mundësinë të mësojmë edhe më shumë për vlerat e demokracisë. Kuvendi, po ashtu, lejon që populli të votojë për personin, për të cilin mendon se është i denjë për ta përfaqësuar vendin. Kjo tregon që në shtetin e Kosovës ka demokraci dhe secili qytetar ka të drejtën ta udhëheq vendin duke votuar. Kjo i bie se në të ardhmen, në mesin e 120 deputetëve mund të jemi edhe ne, nëse populli do na besojë votën. Ne mendojmë se Kuvendi është institucioni më i përkryer që i shërben popullit. Ky ishte përshkrimi ynë për këtë institucion.



janë miratuar aq shumë ligje sa që është vendosur një lloj strukture. Kjo strukturë përcakton se si qytetarët duhen të sillen dhe se si duhet të veprojnë në komunitetin e tyre.

Dy ndër ligjet që më së shumti na pëlqejnë, janë: ligji për arsimin dhe ligji kundër diskriminimit. Ne dëshirojmë t’iu tregojmë për rëndësinë e ligjit kundër diskriminimit. Ky ligj thekson se duhet: „Të bëhet parandalimi dhe luftimi i diskriminimit, ngritja e shkallës



Jemi qytetarë të përgjegjshëm të Kosovës

# E DREJTA PËR TË ZGJEDHUR NË DEMOKRACI

ANDRE (11), ENDA (11), NOL (12), VALZA (11), OLTİ (12), ANESA (11), ANAT (11)

Vota është e fshehtë, dhe të gjithë kemi të drejtë të votojmë vetëm një herë, gjatë një procesi zgjedhor



## Ne jemi qytetarë demokratë, sepse i praktikojmë të gjitha elementet e demokracisë. Këto elemente janë shumë të rëndësishme

Në jetën e përditshme, ne bëjmë zgjedhjen e ushqimit, të veshjes, të vendit për pushim, të shkollimit, të vendbanimit, etj. Në vazhdim do të tregojmë një shembull të një qytetari, se si ai e ka bërë një zgjedhje të tij.

Një qytetar i quajtur Arben bashkë me familjen e tij dëshirojnë ta ndërtojnë një shtëpi. Anëtarët e asaj familje nuk mund të vendosin se si do të duket dizajni i shtëpisë së tyre. Zotëriu e angazhon një arkitekt dhe ai iu sjell këto alternativa: një shtëpi të vogël dhe modeste, një të mesme me tri dhoma gjumi, si dhe një të madhe me dy hyrje kryesore. Kështu, ata mund të zgjedhin se cila nga këto alternativa iu përshtatet. Secili prej nesh ka të drejtën e shkollimit. Një ditë,

secili do të zgjedhë se çfarë profesioni do të ketë në të ardhmen. Profesioni ynë duhet të përshtatet me dëshirat tona.

Nga këta shembuj, ne e kuptuam se çdo gjë në jetën tonë është e bazuar në zgjedhjet që i bëjmë. Një tjetër zgjedhje është edhe ajo e udhëheqësve të shtetit tonë. Një shtet duhet të ketë disa udhëheqës të caktuar, të cilët zgjedhen me anë të votave.

Në Kosovë kemi dy lloje të zgjedhjeve: zgjedhjet lokale (komunale) dhe zgjedhjet qendrore (parlamentare). Zgjedhjet bëhen çdo 4 vjet. Andaj, ne duhet të mendojmë mirë para se të bëjmë këtë zgjedhje. Të drejtën e votës, mund ta përdorim që nga moshën 18 vjeçare, sepse atëherë do të jemi më të pjekur dhe mund ta bëjmë zgjedhjen e duhur. Shpresojmë se e keni kuptuar peshën e rëndë të votës në demokraci dhe besojmë se të gjithë do ta përdorin këtë të drejtë.



E drejtë, e cila vlen për të gjithë qytetarët pa asnjë dallim



Autorët e artikullit të zgjedhjeve

## MEDIA, MJET INFORMIMI

JETRIT (12), ARNIS (11), ARIDA (11), ARMIRA (12), JONILA (11), ANISA (11), ENDI (11), SEJID (11)

**Në demokraci media njihet ndryshe edhe si „Pushtet i Katërt“. Se cili është roli i medias në shoqëri mund ta kuptoni nga ky artikull**


Me zhvillimin e teknologjisë, qasja në media është bërë shumë e lehtë. Kështu, në jetën e përditshme kemi mundësi të informohemi për shumë gjëra, të cilat ndodhin në vendin tonë, si dhe në të gjithë botën. Në demokraci, informimi i qytetarëve për atë çfarë ndodh në vend ka rëndësi të madhe. Pasi përmendëm demokracinë, tani po e tregojmë edhe kuptimin e saj. Pra, me fjalën demokraci kuptojmë formën e qeverisjes, e cila i jep të drejta popullit, pa dallim gjinie, race apo feje. Synimi i demokracisë është edhe barazia. Media luan rol të madh tek ne qytetarët dhe të gjithë e kemi të drejtën e informimit. Informatat të cilat i marrim duhen të jenë të sakta, të paanshme dhe objektive. Media ndonjëherë mund edhe të keqpërdoret. Prandaj, ne si qytetarë duhet të jemi të kujdesshëm në selektimin e informatave. Për shembull, për shkak që ka numër të madh të radiotelevizioneve, portaleve, etj., nëse dëshirojmë të dijmë për ndonjë çështje, është mirë që të hulumtojmë sa më shumë dhe të analizojmë se cilat informata janë të sakta.



Grupi „Alfa“



Gazetari duke intervistuar një qytetarë për demokracinë dhe për rolin që e kanë qytetarët në shtetin e tyre



Sipas nenit 42, në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, censura është e ndaluar dhe garantohet liria e medias



Përfaqësuesi i popullit duke folur para medias



Ndërlidhja e qytetarëve me median



## IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI  
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA  
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



**ERSTE Stiftung**

Redaktohet nga  
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit  
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga  
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:  
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Mazllum Këpuska“  
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: VI-1  
Website: www.demos-ti.org Vendi: Gjakovë